



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 211

Tiranë – E Mërkurë, 14 Janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 173/2014 datë 18.12.2014	Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 12719
Ligj nr. 176/2014 datë 18.12.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 12726
Ligj nr. 178/2014 datë 18.12.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”..... 12727
Ligj nr. 179/2014 datë 18.12.2014	Për një ndryshim në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 12731
Ligj nr. 180/2014 datë 18.12.2014	Për një ndryshim në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”..... 12731
Ligj nr. 184/2014 datë 24.12.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, përfaqësuar nga Komisioni Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e unionit “Doganat 2020”..... 12732



LIGJ
Nr. 173/2014

PËR DISIPLINËN NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i normave dhe rregullave të hollësishme të sjelljes e të etikës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, i kategorive dhe llojeve të shkeljeve, masave disiplinore, si dhe i autoriteteve kompetente për dhënien e tyre.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandim-kontrollit në Forcat e Armatosura për të siguruar përmbushjen e misionit të tyre kushtetues.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për fushën e veprimtarisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Subjektet

Subjektet, sipas këtij ligji, janë ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, kursantët, si dhe ushtarakët në rezervë kur janë në shërbim ushtarak për stërvitje ose shërbim gjatë një mobilizimi ushtarak.

Neni 5
Juridiksioni territorial

Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj për ushtarakët shqiptarë, kur ata janë dërguar me mision, shërbim, stërvitje të përbashkët, mision diplomatik ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe.

Neni 6
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Epror” është ushtaraku, i cili, në bazë të gradës apo funksionit, ushtron autoritet mbi ushtarakët vartës.

2. “Vartës” është ushtaraku, i cili është nën autoritetin e një personi që ka gradë apo funksion më të lartë.

3. “Dhënie e informacionit” është dhënia, përhapja, transmetimi i informacionit, me dashje ose nga pakujdesia, të tretëve, në formë elektronike, shkresore ose verbale.

4. “Situatë emergjente” është situata e shkaktuar nga faktorë natyrorë, industrialë ose nga veprimet e njerëzve, e cila mund të sjellë ose ka sjellë dëmtrim të menjëhershëm e të rëndë për jetën, shëndetin e njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë ose ambientit, duke prishur normalitetin e jetës së komunitetit dhe të shërbimeve të Forcave të Armatosura.

5. “Shkelje disiplinore” është çdo veprim, mosveprim, sjellje apo qëndrim, që bie në kundërshtim me këtë ligj, i kryer nga ushtarakët e Forcave të Armatosura.

6. “Masë disiplinore” është masa me karakter ndëshkues ose parandalues, e përcaktuar në këtë ligj, që merret ndaj ushtarakut nga autoritetet përgjegjëse kur ai kryen shkelje disiplinore.

Neni 7
Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore ndaj ushtarakëve të Forcave të Armatosura, me përjashtim të atyre me grada madhore, janë:

a) Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, vetëm për



dhënien e masave shumë të rënda disiplinore për të gjithë oficerët e Forcave të Armatosura;

b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, vetëm për masat e lehta dhe të rënda për:

i) ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturave, me drejtues civilë, të varësisë së tyre të drejtpërdrejtë;

ii) ushtarakët që shërbejnë në shtabet e NATO-s, në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare;

iii) zëvendëskomandantët, shefat e shtabeve të komandave të forcave dhe strukturave mbështetëse dhe strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

Për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore;

c) komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, si dhe ato të strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për masat e lehta dhe të rënda, për ushtarakët në varësi të tyre në nivel batalioni e lart, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike;

ç) komandantët në nivel batalioni, për masat e lehta dhe të rënda, për ushtarakët në varësi të tyre, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike;

d) komandantët në nivel kompanie dhe toge, për masat e lehta, për ushtarakët në varësi të tyre, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike.

2. Ndaj oficerëve me grada madhore mund të jepen vetëm masa shumë të rënda disiplinore.

3. Autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra dhe lirim nga Forcat e Armatosura”, për oficerët me gradë madhore është Presidenti i Republikës. Propozimi për dhënien e kësaj mase disiplinore Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura bëhet nga Kryeministri, ndërsa për oficerët e tjerë me grada madhore bëhet nga Ministri i Mbrojtjes.

4. Autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Ulje e pagës” për oficerët me grada madhore është Ministri i Mbrojtjes me propozim të Komisionit të Lartë Disiplinor.

Neni 8

Komisioni disiplinor

1. Në strukturat në nivel batalioni e lart ngrihen dhe funksionojnë komisionet disiplinore, që kanë në përbërje jo më pak se tre oficerë të strukturës përkatëse, me grada të njëjta ose më të larta se ato të ushtarakut, ndaj të cilit procedohet disiplinarisht.

2. Nuk mund të jetë pjesë e komisionit disiplinor autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore, si dhe personi që ka konstatuar shkeljen apo që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej saj.

3. Komisionet disiplinore janë përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve nga ushtarakët e ndëshkuar me masa të rënda disiplinore. Në përfundim të shqyrtimit komisioni disiplinor vendos lënien në fuqi të masës disiplinore, ndryshimin ose shfuqizimin e saj. Vendimi i komisionit disiplinor miratohet nga autoriteti përgjegjës i një shkalle më të lartë se ai që ka dhënë masën, ndaj së cilës është bërë ankim.

4. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe përbërja e komisioneve disiplinore përcaktohen me rregullore të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 9

Komisioni i Lartë Disiplinor

1. Në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ngrihet dhe funksionon Komisioni i Lartë Disiplinor, që ka në përbërje jo më pak se pesë oficerë me grada të njëjta ose më të larta se ato të ushtarakut, ndaj të cilit procedohet disiplinarisht. Në rast të procedimit ndaj një ushtaraku me gradë madhore, përbërja e komisionit është jo më pak se tre oficerë me grada madhore.

2. Nuk mund të jetë pjesë e Komisionit të Lartë Disiplinor autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore, si dhe personi që ka konstatuar shkeljen apo që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej saj.



3. Komisioni i Lartë Disiplinor është përgjegjës për shqyrtimin e procedimeve disiplinore për shkelje shumë të rënda disiplinore, të kryera nga ushtarakët e Forcave të Armatosura. Në përfundim të shqyrtimit Komisioni i Lartë Disiplinor vendos dhënien ose jo të masës disiplinore.

4. Vendimi i Komisionit të Lartë Disiplinor miratohet nga autoriteti përgjegjës, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji.

5. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe përbërja e Komisionit të Lartë Disiplinor përcaktohen me rregullore të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

KREU II

SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 10

Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

Shkeljet disiplinore klasifikohen:

- a) të lehta;
- b) të rënda;
- c) shumë të rënda.

Neni 11

Shkeljet disiplinore të lehta

Shkelje disiplinore të lehta janë:

- a) veprimi në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e administrimit e dokumenteve apo materialeve shkresore, elektronike dhe filmime;
- b) mosraportimi i përdorimit të armës së zjarrit;
- c) pranimi i dhuratave ose ndonjë përfitimi nga vartësit apo personave të tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak;
- ç) mosrespektimi i rregullave të nderimit, sipas shkallës hierarkike;
- d) moszbatimi i detyrave të dhëna nga eprori i drejtpërdrejtë ose jo;
- dh) veprime me dashje, të cilat çojnë në paaftësi fizike të vetë ushtarakut, me qëllim shmangien nga detyrat e ngarkuara;
- e) mosdeklarimi i përdorimit të medikamenteve për arye mjekësore, që krijojnë efekte në sjelljen ose aftësitë fizike të tij;
- ë) publikimi në rrjetet sociale të pamjeve personale apo të çdo efektivit të Forcave të Armatosura me armatim ushtarak;
- f) mosrespektimi i orarit të punës;

g) prishja e qetësisë në njësi ose reparte ushtarake, kur nuk përbën vepër penale;

gj) përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura për qëllime private gjatë apo pas kryerjes së detyrës, përjashtuar rastet kur është i autorizuar për këtë gjë;

h) përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura pa dokumentacionin përkatës;

i) përdorimi i paautorizuar i sendeve personale dhe ushtarake të ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura;

j) përdorimi dhe shfrytëzimi i korrespondencës zyrtare për qëllime private;

k) mosraportimi i shkeljes disiplinore;

l) mosdhënia e ndihmës ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ato kanë nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet.

Neni 12

Shkelje disiplinore të rënda

1. Shkelje disiplinore të rënda janë:

a) kryerja e riteve fetare me uniformë, në institucionet fetare, jashtë ambienteve të Forcave të Armatosura;

b) publikimi apo dhënia në media e informacioneve, që lidhen me veprimtarinë e Forcave të Armatosura, si dhe shpërndarja e dokumenteve zyrtare të paklasifikuara, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

c) dhënia ose mundësimi i dhënies së informacioneve me karakter ushtarak, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme, personave të paautorizuar ose medias, kur nuk përbën vepër penale;

ç) përdorimi i pajisjeve elektronike për regjistrimin dhe/ose filmimin e bisedës me eprorët, vartësit dhe kolegët, për çfarëdolloj arsyeje, pa dijeninë e tyre, kur nuk përbën vepër penale dhe përveç rasteve të parashikuara me ligj;

d) shprehja e kritikave publike ndaj Forcave të Armatosura, në formë shkresore, elektronike apo verbale, që cenojnë imazhin e institucionit apo personalitetin e ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura;

dh) fshehja, ndryshimi ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare në formë shkresore ose elektronike;



e) dhënia me dashje e informacionit të gabuar, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

ë) shkelja e rregullave të mbajtjes dhe përdorimit të teknikës e pajisjeve të Forcave të Armatosura;

f) mbajtja dhe përdorimi i armës nga ushtaraku i Forcave të Armatosura në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

g) mbajtja e armëve individuale private, me leje, në ambientet ushtarake;

gj) veprime, qëndrime apo shfaqje diskriminuese në bazë etnie, fetare, race, krahine, bindjeje politike, fetare a filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore;

h) përdorimi i pijeve alkoolike gjatë punës/shërbimit apo në rastet kur është me uniformë, me përjashtim të aktiviteteve zyrtare;

i) dhënia e uniformës me shenjat dhe simbolet dalluese ushtarake, dokumentit të Forcave të Armatosura ose pajisjeve të tjera ushtarake personave të tjerë;

j) mbajtja e uniformës ushtarake në lokale nate, kazino, lojëra fati dhe në ambiente të tjera të ngjashme me këto;

k) mbajtja në mënyrë të parregullt, ndryshimi ose keqpërdorimi i uniformës dhe shenjave ushtarake;

l) mungesa, mosparaqitja në shërbim/punë apo largimi nga vendi i shërbimit/punës, pa arsye të justifikuara deri në 5 ditë, për ushtarët dhe deri në 7 ditë, për oficerët dhe nënoficerët;

ll) mosparaqitja në punë apo shërbim jashtë orarit të përcaktuar, kur i kërkohet nga eprorët e tij, pa arsye të justifikuara;

m) ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari;

n) ngacmimet seksuale, në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale, të kryera gjatë ose jashtë orarit të punës;

nj) lëvizja e gabuar nga pakujdesia e teknikës ose mjetit tokësor, detar, ajror nga ushtaraku, kur nuk përbën vepër penale;

o) shkelja e rregullave të shërbimit, kur nuk përbën vepër penale;

p) përdorimi i lojërave të bixhozit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale;

q) rezistenca ndaj procedimit disiplinor ose refuzimi i kryerjes së masave disiplinore;

r) dëshmia e rreme gjatë procedimit disiplinor;

rr) përkrahja apo ndihma në kryerjen e një shkeljeje të përcaktuar në këtë ligj ose pengimi apo parandalimi për kapjen, gjykimin a dënimin e ushtarakut, i cili ka kryer një shkelje të dënueshme nga ky ligj;

s) mosmarrja e masave të nevojshme për ndërprerjen e shkeljes disiplinore që po kryhet nga vartësit e tij dhe/ose për parandalimin e pasojave të mëtejshme që mund të vijnë prej saj;

sh) kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës.

2. Kryerja e shkeljes së tretë disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje shumë e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet shumë të rënda, sipas nenit 13 të këtij ligji.

Neni 13

Shkelje disiplinore shumë të rënda

Shkelje disiplinore shumë të rënda janë:

a) mbështetja e fushatës së një partie ose organizate politike apo e një anëtarit të një partie politike ose të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht a financiarisht;

b) ndihma, përkrahja ose pjesëmarrja në aktivitete të organizatave politike, fetare ose jofitimprurëse, gjatë orarit të punës, në vendin e punës ose në mjetet ushtarake, si dhe në rastet kur mban uniformën ushtarake ose shenja të saj;

c) lejimi i personave nga organizata politike, fetare apo çdo organizatë tjetër jofitimprurëse të bëjnë propagandë në ambientet e Forcave të Armatosura dhe në mjetet që ato disponojnë;

ç) përdorimi, shpërndarja apo vendosja në mjetet ose në ambientet ku shërbejnë Forcat e Armatosura e simboleve apo reklamave të organizatave, politike apo shoqërore, me përjashtim të atyre me karakter humanitar;

d) ushtrimi i funksioneve i ndikuar nga bindjet e tij politike ose nga interesat personale ose shoqërore;

dh) organizimi, nxitja apo pjesëmarrja në grevë;

e) përdorimi i substancave të paligjshme dhe lëndëve narkotike, kur nuk përbën vepër penale.



Neni 14

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore, që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje të lehta, janë:

a) “Qortimi”, e cila është masa që i jepet verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarakut të Forcave të Armatosura për shkelje të lehta të disiplinës ushtarake;

b) “Detyra shtesë”, e cila është masa për të kryer detyra të tjera, pa përfshirë punët fizike, që u jepen oficerëve deri në gradën kapiten, si ndëshkim, përveç detyrës së zakonshme. Për nënoficerët dhe ushtarët mund të jepen dhe detyra shtesë me punë fizike. Ushtarakut nuk i jepen detyra shtesë, të cilat përbëjnë rrezikshmëri për jetën dhe shëndetin e tij ose që cenojnë dinjitetin e tij;

c) “Punë jashtë orarit”, e cila është masa që u jepet ushtarakëve të Forcave të Armatosura për t’u kryer mbas orarit zyrtar të punës, por jo më shumë se 4 orë dhe pa të drejtë page. Ky dënim nuk mund të jepet në fundjavë dhe në ditët e festave zyrtare. Puna konkrete dhe mënyra e kryerjes së saj përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për dhënien e masës.

2. Masat disiplinore, që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje të rënda, janë:

a) “Vërejtje me shkrim”, e cila është masa me shkrim drejtuar ushtarakut të Forcave të Armatosura;

b) “Kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar”, e cila është masa e kufizimit të lëvizjes fizike të një ushtaraku, brenda kufijve të përcaktuar të repartit, me urdhër të shkruar, por jo më shumë se 72 orë. Ushtarakut, të cilit i jepet kjo masë, kryen të gjitha detyrat ushtarake, përveç rasteve kur urdhërohet ndryshe;

c) “Ndalim disiplinor”, e cila është masa e kufizimit fizik të një ushtaraku brenda mjediseve të përcaktuara për këtë qëllim, me urdhër të shkruar, por jo më shumë se 72 orë. Ky mjedis mund të jetë një dhomë, tendë ose kabinë në anije. Ushtarakët gjatë ndalimit nuk kryejnë detyra ushtarake, përveç rasteve të situatave emergjente;

ç) “Gjobitje në pagë”, e cila është masa e ndalimit të një pjese të pagës pa të drejtë rimarrjeje. Kjo sasi nuk mund të tejkalojë 1/4 e pagës neto mujore.

3. Masat disiplinore, që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje shumë të rënda, janë:

a) “Vërejtje me paralajmërim”, e cila është masa me shkrim, e motivuar, drejtuar ushtarakut të Forcave të Armatosura, për lirim nga Forcat e Armatosura;

b) Ulje e pagës”, e cila është masë nëpërmjet së cilës ushtaraku do të trajtohet me pagën e deri një grade më të ulët për jo më shumë se një vit;

c) “Shkarkimi dhe lirimi nga Forcat e Armatosura”, e cila është masë ekstreme e dhënë për shkelje shumë të rënda disiplinore.

4. Të gjitha masat disiplinore, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, shënohen në dosjen personale të ushtarakut.

Neni 15

Raportimi i shkeljeve disiplinore

1. Raportimi për shkeljet disiplinore, të kryera nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, bëhet në repartin, ku ai shërben, nga personeli ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura si dhe nga çdo individ tjetër, që konstaton shkeljen disiplinore.

2. Raportimi bëhet sipas një formati standard, i cili miratohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

KREU III

ECURIA DISIPLINORE

Neni 16

Ecuria disiplinore

1. Me ecuri disiplinore kuptohet gjithë veprimtaria që kryhet, që në momentin e vënies në djeni me shkrim të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen deri në marrjen e një vendimi për ndëshkimin disiplinor ose mosndëshkimin e tij.

2. Në përcaktimin e masës disiplinore të ushtarakut të Forcave të Armatosura merren parasysh koha, vendi, shkaqet, rëndësia e shkeljes, shkalla e fajësisë, rrethanat lehtësuese e rënduese, si dhe pasojat e shkeljes disiplinore.

3. Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, merr vendim për dhënien ose jo të masës disiplinore brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore. Për raste komplekse, ky afat mund të zgjatet nga autoriteti përgjegjës, por, në çdo rast, jo më shumë se 15 ditë. Zgjatja e afatit bëhet me shkrim dhe i njoftohet edhe ushtarakut, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor.



4. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

Neni 17

Të drejtat e ushtarakut gjatë procedimit disiplinor

1. Me fillimin e ecurisë disiplinore ushtaraku vihet në dijeni, me shkrim, për elementet e procedimit disiplinor të nisur ndaj tij.

2. Ushtaraku, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të dëgjohet nga autoriteti përgjegjës ose komisioni disiplinor përkatës, si dhe të parashtrorë prova dhe fakte në lidhje me pafajësinë e tij.

3. Të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të parashtruar prova e fakte ushtaraku e ushtron personalisht.

4. Në rastet e procedimeve për shkelje shumë të rënda disiplinore, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të parashtruar prova e fakte, ushtaraku e ushtron vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ushtarak të zgjedhur prej tij. Nëse nuk është në gjendje të gjejë një përfaqësues, bën kërkesë me shkrim tek autoriteti përgjegjës ose komisioni disiplinor përkatës, i cili i cakton një përfaqësues ushtarak të profilit jurist për mbrojtjen e tij.

Neni 18

Rrethanat lehtësuese

1. Rrethana lehtësuese gjatë kryerjes së një shkeljeje disiplinore konsiderohen:

a) mungesa e përvojës në punë të ushtarakut të Forcave të Armatosura;

b) kryerja e shkeljes për herë të parë;

c) vlerësime dhe rezultate të mira në punë;

ç) sjellja korrekte e ushtarakut.

2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën më të lehtë të kategorisë konkrete.

Neni 19

Rrethanat rënduese

1. Rrethana rënduese gjatë kryerjes së një shkeljeje disiplinore konsiderohen:

a) kryerja e shkeljes disiplinore në publik;

b) përsëritja e shkeljes përkatëse ose e shkeljeve të tjera;

c) ndëshkimi i mëparshëm me masë disiplinore;

ç) përvoja e punës, të paktën dy vjet, në atë shërbim;

d) ardhja e pasojave prej shkeljes disiplinore;

dh) vlerësime dhe rezultate jo të mira në punë;

e) kryerja në të njëjtën kohë e më shumë se një shkeljeje disiplinore;

ë) kryerja e shkeljes disiplinore në bashkëpunim;

f) kryerja e një shkeljeje disiplinore gjatë kohës që është duke vuajtur dënimin për një tjetër shkelje disiplinore;

g) kryerja e një shkeljeje disiplinore gjatë kohës që është në procedim disiplinor për një shkelje tjetër disiplinore;

gj) kryerja e shkeljes disiplinore në situatë lufte, si dhe në mision apo stërvitje jashtë vendit.

2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje disiplinore në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën më të rëndë të kategorisë konkrete.

Neni 20

Pezullimi disiplinor

1. Pezullimi disiplinor i ushtarakut nis nga momenti i njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore për shkelje të rënda dhe shumë të rënda disiplinore, deri në dhënien e vendimit, me qëllim mospengimin e procedimit disiplinor si dhe parandalimin e kryerjes së shkeljeve të tjera.

2. Pezullimi disiplinor nuk përbën ndëshkim disiplinor.

3. Pezullimi disiplinor jepet me shkrim, rast pas rasti, nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7 të këtij ligji.

4. Në rastet se ecuria disiplinore ka nisur ndaj një ushtaraku me gradë madhore, autoriteti përgjegjës për pezullimin disiplinor është Ministri i Mbrojtjes.

5. Ndaj ushtarakut të Forcave të Armatosura që pezullohet nga detyra, autoriteti përgjegjës mund të vendosë gjatë periudhës së pezullimit një ose më shumë nga kufizimet e mëposhtme:

a) heqjen e së drejtës për të hyrë i pashoqëruar në ambientet e Forcave të Armatosura;

b) heqjen e së drejtës për të mbajtur pajisjet personale të punës;

c) heqjen e së drejtës për të pasur akses në materialet me informacion të klasifikuar.



Neni 21

Parashkrimi i masës disiplinore

1. Masa disiplinore nuk mund t'i jepet një ushtaraku të Forcave të Armatosura, nëse shkelja nuk është zbuluar brenda 12 muajve nga kryerja e saj.

2. Në rast të kryerjes së shkeljeve shumë të rënda disiplinore, masa nuk mund të jepet, nëse nuk është zbuluar brenda 24 muajve nga kryerja e saj.

Neni 22

Ndërprerja e masës disiplinore

1. Masat disiplinore “Kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar” dhe “Ndalim disiplinor” mund të ndërpriten nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, kur nga momenti i ekzekutimit të masës ka kaluar jo më pak se një e treta e afatit të shlyerjes së saj.

2. Në urdhrin për ndërprerjen e masës disiplinore, autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, duhet të argumentojë arsyet për heqjen e saj.

Neni 23

Rehabilitimi

Rehabilitohen:

a) ushtarakët e Forcave të Armatosura, ndaj të cilëve është marrë një masë e lehtë disiplinore, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, dhe që për një periudhë 6-mujore nuk kanë kryer asnjë shkelje tjetër disiplinore. Në përfundim të kësaj periudhe masa disiplinore hiqet nga dosja personale e ushtarakut;

b) ushtarakët e Forcave të Armatosura, ndaj të cilëve është marrë një masë e rëndë disiplinore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 14, të këtij ligji, dhe që për një periudhë 1-vjeçare nuk kanë kryer asnjë shkelje tjetër të rëndë disiplinore. Në përfundim të kësaj periudhe masa disiplinore hiqet nga dosja personale e ushtarakut.

Neni 24

Veprimet procedurale

Veprimet procedurale që nga konstatimi i shkeljes deri në dhënien e vendimit përfundimtar për dhënien ose jo të masës përkatëse nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, përshtirë dhe afatet për përgatitjen e mbrojtjes, përcaktohen me

udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 25

Ankimi për masat disiplinore

1. Ankimi për masat e lehta disiplinore, të dhëna nga komandantët në nivel toge, kompanie ose batalioni, bëhet tek eprori i drejtpërdrejtë i autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore.

2. Për masat e lehta disiplinore, të dhëna nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, si dhe ato të strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nuk lejohet ankimi.

3. Ankimi për masat e rënda disiplinore, të dhëna nga komandantët në nivel batalioni, bëhet tek komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse përkatëse.

4. Ankimi për masat e rënda disiplinore, të dhëna nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse apo strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, bëhet tek Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

5. Ankimi për masat e rënda dhe shumë të rënda disiplinore, të dhëna nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

6. Ankimi për masat e dhëna nga Ministri i Mbrojtjes dhe Presidenti i Republikës bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

7. Ankimi në rrugë gjyqësore për masat disiplinore bëhet vetëm pas ezaurimit të ankimit administrativ, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

8. Ankimi administrativ për masat disiplinore bëhet brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për masën e dhënë.

9. Autoriteti përgjegjës, tek i cili bëhet ankimi, merr vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për ankimin.

10. Ankimi administrativ për masat e rënda disiplinore pezullon ekzekutimin e masës deri në marrjen e vendimit nga autoriteti përgjegjës. Bën përjashtim nga ky rregull ankimi ndaj masës disiplinore të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 14, të këtij ligji.



KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, 9, pika 5, 15, pika 2, dhe 24 të këtij ligji.

Neni 27

Shfuqizime

Ligji nr. 9183, datë 5.2.2004, “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 28

Aktet nënligjore në fuqi

Aktet nënligjore, të nxjerra para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2014

KRYETARI

Ilir Meta**LIGJ****Nr. 176/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
7895, DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Faqe | 12726

Neni 1

Në kreun III, “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, emërtimi i seksionit XI, “Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës”, ndryshohet dhe zëvendësohet me “Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve”.

Neni 2

Neni 199/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 199/a

Ndërtimi i paligjshëm

Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.”.

Neni 3

Pas nenit 199/a shtohet neni 199/b me këtë përmbajtje:

“Neni 199/b

Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm

Cilido që ofron dhe kryen shërbime sipërmarrjeje, mbikëqyrjeje, zbatim punimesh në një ndërtim të paligjshëm, dënohet me burgim deri në 3 vjet.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2014

Shpallur me dekretin nr. 8893, datë 9.1.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 178/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 152/2013
“PËR NËPUNËSIN CIVIL”

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 107 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës “gj” shtohen shkronjat “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l” me këtë përmbajtje:

“h) punonjësve që realizojnë atributet e agjentit/oficerit të Policisë Gjyqësore dhe ata që sipas ligjit lejohet të mbajnë armë;

i) civilët në strukturat e Forcave të Armatosura;

j) punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;

k) punonjësit e bordeve të kullimit;

l) avokatët pranë Avokatit të Shtetit.”.

Neni 2

Në nenin 3, pika 2, hiqet shkronja “b” dhe pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Mund të rregullohen me ligj të posaçëm elemente të marrëdhënieve të shërbimit civil në shërbimin e jashtëm.”.

Neni 3

Në nenin 6, pika 2 shfuqizohet.

Neni 4

Kudo në ligj emërtimet “ministri” ose “Ministria e Brendshme” zëvendësohen me emërtimin “ministri përgjegjës për administratën publike”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Departamenti i Administratës Publike përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për administratën publike.”.

2. Në pikën 2, pas shkronjës “h” shtohet shkronja h/1 me këtë përmbajtje:

“h/1) harton dhe miraton rekomandimet për politikatat e trajnimeve të nëpunësve civilë.”.

Neni 6

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Buxheti i ASPA-s është zë i veçantë në programin e miratuar për administratën publike në Buxhetin e Shtetit.”.

2. Në pikën 6, pas fjalëve “Në përbërje të tij janë” shtohen fjalët “Drejtori i ASPA-s”.

3. Në pikën 8, pas fjalëve “ASPА detyrohet të bashkëpunojë me DAP-in,” shtohen fjalët “duke marrë në konsideratë rekomandimet e miratuara prej tij”.

Neni 7

Në nenin 23, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Vendet e lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme, mund të plotësohen nga kandidatët fitues të paemëruar ende, sipas renditjes së tyre në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni. Në asnjë rast ky proces nuk realizohet pa pëlqimin e kandidatëve fitues dhe nuk cenon të drejtat që ata gëzojnë, sipas pikës 3 të këtij neni. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve, pas marrjes së pëlqimit të tyre.”.

Neni 8

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë:

a) përzgjedhjen e kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; ose

b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.”.



Neni 9

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese

1. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

2. Këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20 të këtij ligji.

3. Mund të aplikojnë për procedurat, sipas pikës 1 të këtij neni:

a) nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele;

b) nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

4. Përfundimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

5. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira;

b) vlerësimi i kandidatëve.

6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i pranimit, që ngrihet nga njësia përgjegjëse.

7. Në përfundim të vlerësimit, komiteti mund të vendosë:

a) përzgjedhjen e kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; apo

b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.

8. Nëse vendi i lirë nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 48 të këtij ligji.

9. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese.”

Neni 10

Në nenin 27, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pranimi në TND mund të bëhet vetëm nga personat që kanë përfunduar formimin e thelluar në ASPA, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni dhe në nenin 30, pika 5/1, të këtij ligji.”

Neni 11

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pranimi në programin e formimit të thelluar për TND-në në ASPA bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe nëpunësit e nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, si dhe për çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.”

Neni 12

Në nenin 30, pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Departamenti i Administratës Publike, me kërkesë të nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe pas marrjes së pëlqimit të njësisë përgjegjëse në këto institucione, mund ta emërojë këtë nëpunës në një pozicion TND-je në institucionin e administratës shtetërore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të ndjekë programin e formimit të thelluar të kandidatëve për anëtarë të trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues në ASPA.”

Neni 13

Në nenin 31, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen si më poshtë:



“a) një përfaqësues nga DAP-i, i cili kryeson komisionin;

b) dy përfaqësues nga ASPA, nga të cilët njëri jo nëpunës i ASPA-s”.

Neni 14

Në nenin 32, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore bëhet me konkurrim të organizuar për një apo disa pozicione të lira dhe është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese. Përjashtimisht, titullari/organi vendimmarrës i institucionit mund të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.”.

Neni 15

Në nenin 33, pika 3 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 48, pika 3, shkronja “b”, shifra “30 km” bëhet “45 km”.

Neni 17

Në nenin 50 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së një institucioni, nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur, si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtrim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi, sipas pikës 2 të këtij neni, është i pamundur.”.

2. Pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“7. Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme:

a) deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji;

b) nga 1-3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 3 muajve;

c) nga 3-6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 6 muajve;

ç) nga 6-9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 9 muajve;

d) mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 12 muajve.

8. Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:

a) të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;

b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.

9. Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.

Neni 18

Në nenin 54, pika 1, shkronja “a”, referenca në shkronjën “g” zëvendësohet me shkronjën “gj”.

Neni 19

Në nenin 55, pika 2, pas fjalëve “një interesi tjetër të ligjshëm të tij”, shtohen fjalët “sipas përcaktimeve të vendosura nga Këshilli i Ministrave”.

Neni 20

Neni 56 riformulohet si më poshtë:

“Neni 56

Efektet e pezullimit

1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësit regjistrohen në një listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse. Ata



qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

1/1. Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, t'ia ofrojë fillimisht këtyre nëpunësve civilë, që plotësojnë kriteret përkatëse, duke respektuar në çdo rast shkaqet e përmendura nga neni 48, pika 3, e këtij ligji, i cili në këtë rast zbatohet me ndryshimet përkatëse.

1/2. Këta nëpunës civilë mund të emërohen përkohësisht me pëlqimin e tyre edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

2. Në rastin e pezullimit për një afat deri në 3 muaj, pozicioni i mëparshëm i punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit.

3. Periudha e pezullimit, në rastet e parashikuara nga shkronja “c”, e nenit 53, nga shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 54 dhe nga shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 55 të këtij ligji, llogaritet si vjetërsi në shërbimin civil.

4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë. Në rastet e parashikuara në nenin 53, shkronja “c”, dhe në nenin 54, shkronja “dh”, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, përveç shtesës për kushte pune. Në rastet e parashikuara në nenin 54, pika 1, shkronjat “c” dhe “e”, nëpunësi përfiton pagën e plotë, përveç shtesës për kushte pune.

5. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni.”

Neni 21

Titulli i kreut XI ndryshohet si më poshtë:
“Vlerësimi i nëpunësit civil”.

Neni 22

Në nenin 62 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:
“Vlerësimi në punë”.

2. Fjala e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Përveç vlerësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, edhe për përfutimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, në përputhje me kategorinë/grupin e administrimit të përgjithshëm/posaçëm ku bëjnë pjesë. Në çdo rast, procesi i vlerësimit të kryer sipas kësaj pike, duhet të garantojë anonimatit e nëpunësit civil të vlerësuar.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në rast të vlerësimit jokënaqshëm në procedurën e vlerësimit të njohurive shtesë, sipas pikës 1/1 të këtij neni, nëpunësi i nënshtrohet një trajnimit të detyrueshëm dhe rivlerësimi 3-mujor.”.

Neni 23

Në nenin 64, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.”.

Neni 24

Në nenin 66 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, sipas pikave 6 dhe 7, të nenit 50, të këtij ligji.”.

2. Në shkronjën “c”, të pikës 1, fjalët “për dy vite radhazi”, hiqen.

3. Në pikën 1, pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “e/1”, “e/2” dhe “e/3” me këtë përmbajtje:

“e/1) në rast se anëtari i TND-së, i zgjedhur sipas pikës 5/1, të nenit 30, të këtij ligji, nuk përfundon me sukses trajnimin në ASPA;

e/2) në rastin e parashikuar nga neni 56 i këtij ligji;

e/3) në rast se vlerësohet përsëri “jokënaqshëm” në përfundim të procedurës së rivlerësimit, sipas pikës 2/1 të nenit 62.”.



Neni 25

Pas nenit 66 shtohet neni 66/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 66/1

1. Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse.

2. Nëse rikthimi i nëpunësve civilë në detyrë, sipas pikës 1, të këtij neni, është objektivisht i pamundur, atëherë ata regjistrohen në një listë pritjeje deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse.

3. Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.

4. Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, të emërojë, fillimisht, me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë të regjistruar në listë, sipas kategorisë përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës.

5. Këta nëpunës, me pëlqimin e tyre, mund të sistemohen edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.”.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.12.2014

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 179/2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.
8269, DATË 23.12.1997, “PËR BANKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, 83, pika 1, dhe 161, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 44, pika 3, fjalët “shtetas i Republikës së Shqipërisë” shfuqizohen.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 18.12.2014

LIGJ

Nr. 180/2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.
115/2014 “PËR NDARJEN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË
NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “P”, 83, pika 1, dhe 108, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Vangjel Tavo,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në tabelën e Qarkut Gjirokastrë, Qendra e Bashkisë Dropull bëhet “Fshati Jorgucat”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.12.2014

KRYETARI
Ilir Meta
Faqe | 12731



LIGJ
Nr. 184/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EUROPIAN, PËRFAQËSUAR NGA
KOMISIONI EUROPIAN, PËR
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
UNIONIT “DOGANAT 2020”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, përfaqësuar nga Komisioni Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e unionit “Doganat 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8892, datë 9.1.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE
**NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT
“DOGANAT 2020”**

Komisioni Evropian, më poshtë i referuar si “Komisioni”, në emër dhe në interes të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, më poshtë e referuar si Shqipëria, nga ana tjetër,

Faqe | 12732

duke marrë në konsideratë se:

1. Marrëveshja Kuadër e 22 nëntorit 2004¹ ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shqipërisë, përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Unionit, duke lënë Komisionin dhe autoritetet kompetente të Shqipërisë për të përcaktuar kushtet specifike, përfshirë kontributin financiar, për sa i përket kësaj pjesëmarrjeje në çdo program të veçantë.

2. Sipas nenit 1 (2) të Marrëveshjes Kuadër, Shqipëria lejohet të marrë pjesë në programet e Unionit, të përcaktuara apo të rishikuara dhe të cilat përmbajnë një klauzolë të hapur për pjesëmarrjen e Shqipërisë.

3. Programi Dogana 2020 është përcaktuar nga rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit .../.../KE e [datës] (C2020).

4. Sipas nenit 3 (2) (1) të kësaj rregulloreje nr. XXXXX/EC (C2020), Programi Dogana 2020 është i hapur për pjesëmarrjen e vendeve të mundshme candidate, në përputhje me dispozitat për t'u përcaktuar me këto vende, në vijim të themelimit të marrëveshjeve kuadër në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në programet e Unionit.

5. Shqipëria ka shprehur dëshirën e saj për të marrë pjesë në programin Dogana 2020 dhe ka negociuar me Komisionin një marrëveshje mbi kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar për pjesëmarrjen e saj në program.

kanë rënë dakord si më poshtë,

Neni 1

Programi

Shqipëria duhet të marrë pjesë në programin Dogana 2020 (“Programi”):

- në përputhje me kushtet e Marrëveshjes Kuadër, të 22 nëntorit 2004², ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shqipërisë sipas parimeve të përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Unionit; dhe

- sipas kushteve të neneve 2-4 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Kushtet e pjesëmarrjes në program

1. Shqipëria duhet të marrë pjesë në aktivitetet e programit në përputhje me objektivat, kriteret,

¹ FZ, ligji nr. 192, 22.7.2005, f.2.

² Serbia FZ L192, 22/07/2005, fq.29, Shqipëria: FZ L192, 22.7.2005, fq.2; Bosnja dhe Hercegovina: FZ L192, 22.7.2005, fq.9; Mali i Zi FZ L192, 22/7/2005, fq.29.



procedurat dhe afatet kohore, të përcaktuara në rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit [kodi referues që miraton Programin].

2. Shqipëria duhet të marrë pjesë në aktivitetet e programit sipas kushteve dhe afateve kohore të mëposhtme:

a) aktivitetet e përcaktuara në nenin 7 paragrafi (a) veprime të përbashkëta, nënparagrafi (i), (ii), (iii), (iv), (v), (vi), (vii), (viii), (ix) dhe neni 7, paragrafi (c), ngritja e kompetencave njerëzore të Rregullores C2020/XXXXX, që nga 1 prilli 2014, përveç kur natyra apo përmbajtja e aktivitetit ndalon pjesëmarrjen e Shqipërisë;

b) aktivitetet e përcaktuara në nenin 7 paragrafi (b), mbi sistemet evropiane të informacionit të përmendura në shtojcën I, pika (A) (1) të rregullores C2020/XXXXX. Pjesëmarrja në aktivitete duhet të fillojë:

- në datën e rënë dakord nga të dyja palët në nivel operacional përpara aderimit të Shqipërisë në BE; ose

- me lidhjen e Shqipërisë me Sistemet e Informacionit Evropian, të përmendura në shtojcën I, pika (A) (1), e rregullores, duke pasur parasysh aderimin në Konventën e Përbashkët të Transitit ose në çdo marrëveshje tjetër përkatëse ndërkombëtare që e lejon Shqipërinë të përdorë Sistemet e Informacionit Evropian, të përmendura në shtojcën I, pika (A) (1).

3. Kushtet për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve nga institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm në Shqipëri, duhet të jenë të njëjta me ato institucione, organizata dhe individë të pranueshëm në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

4. Shqipëria duhet të paguajë çdo vit një kontribut financiar në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 3 më poshtë.

5. Kontributi financiar i Shqipërisë duhet t'i shtohet çdo vit shumë në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, e cila është rezervuar për ndarjet e angazhimeve për të përmbushur detyrimet financiare ndaj masave të ndryshme të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

6. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së, duhet të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si edhe për aspekte të tjera administrative të programit.

Neni 3

Kontributi financiar

Rregullat e kontributit financiar të Shqipërisë përcaktohen në shtojcën I.

Rregullat e kontrollit financiar, rikuperimi dhe masat e tjera kundër mashtrimit përcaktohen në shtojcën II.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Komisioni, në partneritet me Shqipërinë, duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme pjesëmarrjen e Shqipërisë në program. Kjo dispozitë nuk ndikon në përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit. Shqipëria duhet të paraqesë te Komisioni raportet përkatëse dhe të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike, të përcaktuara nga BE-ja për këtë kontekst.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje duhet të zbatohet për kohëzgjatjen e programit. Nëse Bashkimi Evropian e shtyn kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda programit, kjo Marrëveshje duhet të zgjatet përkatësisht dhe automatikisht, përveç kur njëra palë e denoncon brenda një muaji pas vendimit të shtyrjes.

Pas përfundimit të Marrëveshjes, duhet të vazhdojnë si më poshtë:

- projektet dhe aktivitetet në progres, në momentin e përfundimit deri në plotësimin e tyre sipas kushteve specifike në këtë Marrëveshje;

- marrëveshjet kontraktuale të zbatueshme për këto projekte dhe aktivitete; dhe

- dispozitat e shtojcës II.

Shtojcat janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të amendohet me shkrim vetëm me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Shqipëria njofton Komisionin që kërkesat e saj të brendshme ligjore janë përmbushur për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje duhet të zbatohet nga 1 janari 2014.

Bërë më më

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë



[emri]
 Ministri i [departamenti ministror]
 Republikës së Shqipërisë
 Bërë më më
 Për Komisionin,
 Në emër të Bashkimit Evropian,
 [emri]
 Anëtar i Komisionit
 për [portofoli]

SHTOJCA I E MARRËVESHJES

Rregullat mbi kontributin financiar të Shqipërisë në dogana 2020

1. Kontributi financiar që Shqipëria duhet të paguajë te buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian duhet të jetë si më poshtë:

- Për aktivitetet e përmendura në nenin 2 (2) a) të kësaj Marrëveshjeje, shumat e mëposhtme:

- 45,000 euro për vitin 2014;
- 50,000 euro për vitin 2015;
- 55,000 euro për vitin 2016;
- 60,000 euro për vitin 2017;
- 65,000 euro për vitin 2018,
- 70,000 euro për vitin 2019,
- 75,000 euro për vitin 2020,

- Për aktivitetet e përmendura në nenin 2 (2) b) të kësaj Marrëveshjeje, një shumë vjetore maksimumi prej 160.000 eurosh nga viti i lidhjes, për të mbuluar kostot për aktivitetet e përmendura në nenin 2 (2) b) të kësaj Marrëveshjeje; Komisioni do të llogarisë dhe përcaktojë çdo vit shumën aktuale të kontributit financiar që do të nevojitet për të zbatuar aktivitetet dhe për t'u paguar duke u bazuar në nevojat e aktiviteteve të përmendura në nenin 2 (2) b) të kësaj Marrëveshjeje. Shuma e kontributit financiar për t'u paguar do t'i komunikohet Shqipërisë në kohën e duhur për mbledhjen e fondeve.

2. Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot në lidhje me:

- pjesëmarrjen e zyrtarëve të administratës doganore të Shqipërisë në aktivitetet e programit të përcaktuara në nenin 2 (2) a) të kësaj Marrëveshjeje;

- aktivitetet e përcaktuara në nenin 2 (2) b) të kësaj Marrëveshjeje për administratën doganore të Shqipërisë.

3. Komisioni rimbursion shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës së përfaqësuesve dhe ekspertëve të Shqipërisë kur marrin pjesë si vëzhgues:

- në komitetin e përmendur në nenin 15 të rregullores që miraton programin; ose
 - në takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit.

Rimbursimi duhet të bëhet sipas të njëjtave kushte dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

4. Rregullorja financiare e zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian duhet të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

5. Kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe në fillim të çdo viti pasues financiar, Komisioni i dërgon Shqipërisë një njoftim për fondet që i korrespondojnë kontributit të saj financiar.

6. Kontributi duhet të paguhet në euro te një llogari bankare në euro të Komisionit.

7. Shqipëria duhet të paguajë kontributin e saj financiar jo më vonë se tre muaj pas datës së njoftimit në përputhje me njoftimin për kërkesën për fondet. Shqipëria do të paguajë interesat e mospagimit mbi shumën e dhënë nga data, në rast të vonesës së pagesës së kontributit. Norma e interesit do të jetë norma:

- e zbatuar në Bankën Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian;

- në fuqi, në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati kohor; dhe

- e shtuar me 3.5 pikë për qind.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në program për vitin përkatës pezullohet nëse Shqipëria nuk e paguan brenda 20 ditëve pune pasi Komisioni t'i ketë dërguar një letër formale rikujtuese dhe në rast se vonesa e pagesës rrezikon në mënyrë thelbësore zbatimin dhe menaxhimin e programit.

SHTOJCA II E MARRËVESHJES

Kontrolli financiar, rikuperimi dhe masa të tjera kundër mashtrimit

I. Kontrollat dhe masat kundër mashtrimit nga Unioni

1. Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të



Bashkimit Evropian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat e nënshkruara me përfituesit e programeve të vendosura në Shqipëri, duhet të parashikojnë që:

- auditet financiare apo audite të tjera mund të kryhen në çdo kohë;
- në ambientet e përfituesve dhe nënkontraktuesve të tyre;
- nga agjentët e Komisionit ose çdo person tjetër të mandatuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë mandatuar nga Komisioni duhet të kenë akses të vendndodhjet, punët dhe dokumentet dhe në të gjithë informacionin e kërkuar, duke përfshirë formatin elektronik, në mënyrë që të kryejnë auditimet. Kjo e drejtë e aksesit duhet të theksohet shprehimisht në kontratat e nënshkruara për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta, si dhe Komisioni.

3. Komisioni/OLAF (Zyra Evropiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrole dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë në përputhje me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom, KE) nr. 2185/96 të 11 nëntorit 1996.

Këto kontrole dhe inspektime duhet të përgatiten dhe drejtohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e Shqipërisë të caktuara nga autoritetet e Shqipërisë. Këto autoritete duhet të njoftohen në kohë mbi objektin, qëllimin dhe bazat ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ato të ndihmojnë nëse është e nevojshme.

Nëse autoritetet e Shqipërisë dëshirojnë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen bashkërisht.

Nëse pjesëmarrësit në programe i rezistojnë një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, duhet t'i japin inspektorëve të Komisionit/OLAF asistencën e nevojshme për të kryer detyrën e tyre.

Komisioni/OLAF duhet t'i raportojë autoriteteve të Shqipërisë çdo fakt apo dyshim të ndonjë parregullsie të vërejtur gjatë kontroleve apo inspektimeve në vend sa më shpejt që të jetë e mundur. Komisioni/OLAF, në çdo rast, duhet të informojë këto autoritete mbi rezultatet e këtyre kontroleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimet

1. Për zbatimin e kësaj shtojce, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe BE-ja duhet të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe të konsultojnë njëra tjetrën nëse kërkohet nga njëra prej palëve.

2. Autoritetet e Shqipërisë duhet të informojnë menjëherë Komisionin mbi çdo fakt apo dyshim të ndonjë parregullsie në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të nënshkruara për zbatimin e instrumenteve sipas kësaj Marrëveshje.

III. Masat administrative dhe gjobat

Komisioni mund të vendosë masa administrative dhe gjoba në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, pa ndikuar në zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë.

IV. Rikuperimi

Komisioni mund të marrë një vendim duke vendosur një detyrim financiar ndaj personave dhe jo Shteteve. Këto vendime duhet të jenë të detyrueshme në përputhje me rregullat e procedurës civile në fuqi në vendin në territorin e të cilit kryhet zbatimi i ligjit. Shqipëria duhet të informojë Komisionin mbi autoritetin kombëtar të caktuar për qëllim të zbatimit të ligjit. Komisioni i kërkon autoritetit kombëtar të verifikojë autenticitetin e vendimit para se urdhri i zbatimit t'i bashkëlidhet vendimit. Pas përfundimit të këtyre formaliteteve, Komisioni mund të zbatojë vendimin e tij në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti i caktuar.

Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në vijim të një klauzole arbitrazhi në ndonjë kontratë sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë të zbatueshme sipas të njëjta kushteve.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni duhet të komunikojë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në Dogana 2020 të vendosur në Shqipëri dhe me nënkontraktuesit e tyre. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që i kërkohet për të paraqitur mbi bazat e instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje dhe të kontratave të nënshkruara për zbatimin e tyre.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë